

Tema mësimore 6.4: Ushtrime mbi zbatimin e ligjit të qëndrueshmërisë së përbërjes dhe ligjit të ruajtjes së masës.


Fusha: Shkencat e natyrës	Lënda: KIMI	Shkalla: V	Klasa: X
Tema mësimore 6.4: Ushtrime mbi zbatimin e ligjit të qëndrueshmërisë së përbërjes dhe ligjit të ruajtjes së masës.		Situata e të nxënit: Njehsime në formula kimike dhe barazime kimike ku gjejnë zbatim ligji i qëndrueshmërisë së përbërjes dhe ligji i ruajtjes së masës.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës/lëndës sipas temës mësimore: <ul style="list-style-type: none"> • Përkufizon ligjin e qëndrueshmërisë së përbërjes dhe ligjin e ruajtjes së masës. • Zbaton ligjin e qëndrueshmërisë së përbërjes dhe ligjin e ruajtjes së masës në shembuj të ndryshëm. • Njehson përqindjen e elementeve përbërëse në një përbërje kimike. • Njehson përqindjen e pastërtisë së një përbërjeje kimike. 		Fjalët kyçe: Ligji i qëndrueshmërisë së përbërjes, ligji i ruajtjes së masës, përqindje e elementeve, përqindje e pastërtisë së një përbërjeje kimike, përbërje e pastër.	
Burimet: Teksti i kimit të klasës së 10-të, libri i mësuesit.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Fizika, matematika, gjuha dhe komunikimi.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
<p>- Përshkrimi i situatës.</p> <p>Mësuesi/ ja njeh nxënësit me situatën e temës. Të menduarit logjik, pyetje – përgjigje. Mësuesi/ja nëpërmjet shembujve kërkon që nxënësit të përfshihen në të menduarit logjik për situatën e dhënë. Nëse jepen masat në gram të substancave që futen në reaksion, a mund të njehsojmë raportin në masë të elementeve në një përbërje? Po masën e substancës produkt që përftohet?</p> <p>Mësuesi/ja njeh nxënësit me dy ligje të rëndësishme të kimit:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Ligjin e qëndrueshmërisë së përbërjes 2) Ligjin e ruajtjes së masës <p>Veprimet në situatë: Analizë e problemit dhe zgjidhja e tij, pyetje – përgjigje.</p>			

- U kërkohet nxënësve të tregojnë ligjin e qëndrueshmërisë së përbërjes dhe atë të ruajtjes së masës
- Nxënësit sjellin shembuj për secilin ligj
- Japin kuptimin e përqindjes (pjesa dhe e tëra), dhe e zbatojnë atë në shembull të dhënë
- Japin kuptimin e pastërtisë dhe e zbatojnë atë në shembull të dhënë
- Kryhet aktiviteti praktik me nxënësit: Puna në grupe:
 1. Gr 1: Kthe thyesat në përqindje ($\frac{1}{2}$ dhe $\frac{12}{36}$).
 2. Gr 2: Kthen përqindjen në thyesë (20% në thyesë).
 3. Gr 3: Njehso përqindjen e elementeve tek një formulë e dhënë (CH_4).
 4. Gr 4: Njehso përqindjen e pastërtisë në një përbërje kimike kur jepet masa e përgjithshme e përbërjes së papastër dhe masa e përbërjes së pastër.

Vlerësimi:

Gjatë kësaj ore mësimore nxënësit vlerësohen në mënyrë individuale për:

- Saktësinë në zbatimin e ligjit të qëndrueshmërisë së përbërjes dhe ruajtjes së masës
- Saktësi në njehsime
- Pjesëmarrjen dhe bashkëpunimin me punën në grup
- Minitest



Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Klasa 3	Data: 22.01.2018
Tema mësimore Përse dielli është në qiell?(Dy orë)		Situata e të nxëniet Mençuria	
<p>R.N.sipas kompetencave të fushës: Kompetenca: Të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> përdor strategjitë e të lexuarit për të kuptuar tekste letrare apo joletrare. dallon temën, mesazhin dhe idetë kryesore në tekste letrare. interpretin dhe analizojnë elemente të thjeshta në një tekst si: subjekti, personazhi kryesor, personazhe dytësore, mjedisi ose hapësira ku zhvillohen ngjarjet etj 			
<p>R.N.të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> lexon tekstin duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjërat që i duken interesante. dallon llojin e tekstit mbi bazën e karakteristikave të tij. u përgjigjet pyetjeve rreth tekstit ose fjalëve të panjohura për të. tregon përmbajtjen me fjalët e tij. shfaq besim dhe vullnet në forcat vetjake për të fituar rrjedhshmërinë e duhur gjatë leximit. 		<p>Fjalë kyçe: dielli qiell shigjetari revan tendosi kalë i zjarrtë mit</p>	
<p>Burimet e informacionit dhe mjete: njohuritë paraprake të nxënësve teksti mësimor, ngjyra, fletë A4, përralla dhe mite që dinë - pamje të diellit - kuriozitete për diellin - informacione nga interneti</p>		<p>Lidhja me fushat e tjera: Artet Shkencat e natyrës Lidhja me temat ndërkurrikulare: -Mjedisi</p>	
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nx: stuhi mendimesh;lexo-diskuto; marrëdhënie pyetje-përgjigje; trego-argumento; punë individuale, punë në dyshe, punë në grup, punë me gjithë klasën. Veprimtaria e parë: <i>Stuhi mendimesh</i> Paraqes pamje të ndryshme të diellit dhe i nxit nxënësit/et të flasin se çfarë dinë për diellin. Përgjigjet e tyre i paraqes në tabelë. Veprimtaria e dytë: <i>Lexo-diskuto</i>: Njihen nxënësit me temën e mësimin. Vëzhgohet dhe komentohet ilustrimi në libër. Nxënësit të lexojnë tekstin në heshtje, duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjërat që i bëjnë përshtypje dhe i duken interesante. Punohet rubrika “Fjalor” për shpjegimin e fjalëve të reja. Nxënësit ndërtojnë fjali me to. Nxiten nxënësit të tregojnë për gjërat që u bënë përshtypje dhe që iu duken interesante gjatë leximit të tekstit. Nxënësit diskutojnë në dyshe dhe tregojnë llojin e tekstit, mbi bazën e karakteristikave të tij. (Mit) Shpjegoj se ç'është miti. – <i>Miti: Përrallë e trilluar, që tregon për gjëra që nuk ndodhin në jetën tonë.</i> Lexim zinxhir nga nxënësit. Veprimtaria e tretë: <i>Marrëdhënie pyetje-përgjigje</i> Në rubrikën “Lexoj dhe kuptoj” nxënësit u përgjigjen pyetjeve rreth tekstit. Ata/ato diskutojnë përgjigjet në dyshe dhe më pas me gjithë klasën. Nxiten nxënësit të tregojnë përmbajtjen me fjalët e tyre. Veprimtaria e katërt: <i>Trego-argumento</i> Në rubrikën “Reflektoj” nxënësit përzgjedhin argumentin e duhur se përse njerëzit në lashtësi besonin se Dielli ishte një kalë i zjarrtë. Nxënësit tregojnë mite të tjera që kanë lexuar. Nxënësit lexojnë kuriozitete dhe informacione nga interneti për diellin. Vlerësimi : Nxënësit do të vlerësohen për: leximin e tekstit duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe gjërat që i duken interesante; - dallimin e llojit të tekstit mbi bazën e karakteristikave të tij; - përgjigjet e dhëna për pyetjet rreth tekstit ose fjalëve të panjohura për të; - tregimin e përmbajtjes me fjalët e tyre; _shfaqjen e besimit dhe vullnetit në forcat vetjake për të fituar rrjedhshmërinë e duhur gjatë leximit; - përzgjedhjen e formës dhe gjuhës së përshtatshme për të përcjellë informacionin, idetë, mendimet e tij në lidhje me mitin për vendosjen e diellit lart në qiell; - demonstrimin e aftësive të bashkëpunimit në grup. Detyrë: Rubrika “Shkruaj”. - Refleksione: Si u ndjetë? Çfarë na shkoi mirë?</p>			

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Gjuhë shqipe	Shkalla: 2 Klasa 3	Data: 12. 02. 2018
Tema mësimore: Gjethja e pemës, era, rrezet e diellit (2 orë)		Situata e të nxënit: Përralla	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës Nxënësi: ❖ Të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare -lexon tekste letrare që u përkasin periudhave të ndryshme, shqipe dhe botërore. -demonstron kuptimin, interpretimin, analizën, vlerësimin dhe gjykimin e këtyre teksteve (të përshtatshme për zhvillimin moshor të nxënësve).			
Rezultatet e të nxënit sipas temës mësimore Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> • pyet dhe u përgjigjet pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit. • lexon rrjedhshëm dhe me intonacionin e duhur. • dallon cilësitë e personazheve, duke u mbështetur tek veprimet e tyre. • tregon brendinë sipas rrjedhës së ngjarjes. • interpreton në role. • shpreh mendimin e tij për mbylljen e kësaj historie. • mban qëndrim ndaj veprimeve të personazheve. • shpreh ndjenjat dhe mendimet personale rreth pjesës që lexon. • ndan me të tjerët përvojat rreth leximit. 		Fjalë kyçe: gjethja e pemës, era, rrezet e diellit, shushurijnë, gdhiu, ranë pingul. Teknika dhe strategji: <ul style="list-style-type: none"> • imagjinatë e drejtuar • parashikim mbi bazën e titullit dhe ilustrimeve • lexo përmbledh në dyshe • lojë • rrjeti i diskutimit • lojë me role 	
Burimet e informacionit dhe mjete: njohuritë paraprake të nxënësve, teksti mësimor, grafiku”Harta e ngjarjes” libra me përralla e tregime të shkurtra pamje të natyrës në vjeshtë mjete shkrimi		Lidhja me fushat e tjera: Shoqëria dhe mjedisi Arte, Shkencat e natyrës Lidhja me temat ndërkurrikulare Të drejtat e njeriut Mjedisi	
<i>Ora e parë</i>			
Përshkrimi kontekstual i situatës: <ul style="list-style-type: none"> ▪ Veprimtari paraprake Hapi 1. Imagjinatë e drejtuar Ftoj nxënësit të mbyllin sytë dhe të mendojnë sikur janë vetëm në një vend për shumë ditë, pa njerëz, shokë e shoqe përreth. Pranë kanë gjithçka që u duhet për të jetuar: ushqime, veshje, lodra, libra etj. - Si do të ndiheshit? A do të mund të jetonit në këtë gjendje për shumë ditë? Veprimet në situatë Hapi 2. Parashikim mbi bazën e titullit dhe ilustrimeve Shkruaj titullin e përrallës, paraqes ilustrimin e saj.. Nxiten nxënësit të parashikojnë ngjarjen mbi bazën e titullit dhe ilustrimit. Për këtë mund të punojnë në dyshe për 3-4’. Dëgjohet ngjarja nga 2-3 dyshe. Hapi 3. Lexo përmbledh në dyshe Lexohet teksti me paragrafë duke punuar në dyshe. Njëri nxënës e lexon, tjetri e përmbledh dhe drejton dy – tre			

pyetje. Për paragrafin tjetër, ndërrojnë rolet.

- Si ishte parashikimi juaj për ngjarjen?

Diskutohen fjalë të reja që mund të kenë nxënësit.

Lexohet përralla në heshtje.

Lexohet nga nxënësit zinxhir.

Punohet rubrika “ Lexoj dhe kuptoj”

Ora e dytë

Hapi 1. Lojë

Paraqiten disa nga fjalët e përrallës në tabelë të fshehura. Nxënësit do të gjejnë secilën prej tyre në mënyrë individuale

Ai që i gjen i pari fiton lojën. Fjalët mund të jenë:

sh_____ p_____ gj_____ p_____

Hapi 2. Harta e ngjarjes

- Punohet me grafikun “Harta e ngjarjes” të parapërgatitur më parë .

Hapi 3. Lojë me role

Organizoj klasën në grupe. Ndahen rolet për çdo grup dhe kërkoj që të lexojnë në heshtje fjalët e rolit përkatës (autori, gjethja, era, rrezja e diellit). Më pas nxënësit të ndarë në katërshe ushtrohen në lexim me zë sipas roleve.

Hapi 4. Rrjeti i diskutimit

Po A veptoi mirë gjethja e pemës që i kërkoi erës t’ia këpuste të gjitha shoqet e saj? Pse? Jo

Nxiten nxënësit të diskutojnë rreth pyetjes duke dhënë argumente pro dhe kundër dhe në fund të dalin në përfundimin:

Ta duam tjetrin me të gjitha cilësitë që ka.

Të vetëm nuk përballojmë dhe nuk shijojmë asgjë.

Punohet rubrika “*Reflektoj*”. Nxënësit japin mendimin e tyre për erën, gjethen e pemës dhe mbylljen e përrallës.

Hapi 5. Punë individuale

- Shkruajnë pjesën që u pëlqen.
- Formojnë fjali me fjalët e reja në situata të tjera.

Lexohen dhe diskutohen me gjithë klasën.

Vlerësimi i situatës:

Vlerësimi bëhet për:

- ❖ parashikimin rreth përmbajtjes së tekstit duke u mbështetur te titulli dhe ilustrimet.
- ❖ leximin rrjedhshëm të tekstit.
- ❖ analizën e personazheve duke u mbështetur në përshkrimet, veprimet e tyre dhe marrëdhëniet me personazhet e tjera.
- ❖ nxjerrjen e mesazhit të pjesës.
- ❖ interpretimin në role
- ❖ shprehjen e ndjenjave dhe mendimeve personale rreth pjesës që lexon.
- ❖ ndarjen me të tjerët të përvojave rreth leximit.

Detyrë shtëpie:

Ritregohet ngjarja me fjalët e tyre.

Rubrika “ Shkruaj”

Refleksione:Çfarë u bëri të ndiheni mirë në këtë orë?

Fusha: Edukim fizik, sporte dhe shëndet	Lënda: Edukim fizik, sporte dhe shëndet	Klasa 3	Data: 12.02.2018
<i>Tema mësimore</i> Gjymnastikë: Kombinim lëvizor (2 orë)		<i>Situata e të nxënësve</i> Lojë	
<i>Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës</i> Nxënësi: <i>Tematika:</i> Edukim nëpërmjet veprimtarive fizike <ul style="list-style-type: none"> • Kryen kombinime lëvizore, me pjesë të ndryshme të trupit. 			
<i>Rezultatet e të nxënësve sipas temës mësimore:</i> Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> • Kryen lëvizje të kombinuara të krahëve dhe këmbëve. • Tregojnë gatishmëri për të ndihmuar të tjerët dhe për të dhënë kontributin personal. 		<i>Fjalë kyçe:</i> Lëvizje, kombinim	
<i>Burimet e informacionit dhe mjete:</i> njohuritë dhe shkathtësitë paraprake të nxënësve libri “ Lojëra lëvizore për moshën 6- 10 vjeç”		<i>Lidhja me fushat e tjera:</i> Gjuhët dhe komunikimi Shkencat e natyrës Edukim me të drejtat e fëmijëve Edukim shëndetësor	
<i>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:</i> Shpjegim, demonstrim, ekzekutim i plotë <i>Veprimtaritë e nxënësve</i> Hapi 1. Përgatitore (20’) Rreshtohen nxënësit, njihen me temën dhe rezultatet e të nxënësve. Vrapim i lehtë ngrohës rreth këndit (2 herë). Ecje rrethore, zik-zake, gjarpërore për rregullimin e frymëmarrjes. Ushtrime përgatitore: <i>përkulje e trupit para- në vend, pas – në vend me katër kohë (3-4 herë)</i> <i>kryqëzim i krahëve para dhe shtytje e tyre anash- lart(3-4 herë).</i> <i>shtytje e krahëve në formën e shkronjës “s” (3-4 herë)</i> Hapi 2. Themelore (50’) Zhvillohet një bisedë në të cilën jepen shpjegimet e duhura, për të mundësuar të kuptuarin e qartë nga nxënësit të kombinimit lëvizor duar - këmbë. Demonstrohet loja 2-3 herë nga një grup nxënësish. Ushtrohen nxënësit në mënyrë të pavarur me grupe. Organizohen nxënësit në ekzekutimin e ushtrimit duke i përfshirë të gjithë. Ndihmoj nxënësit që kanë vështirësi në realizimin e kombinimit. Vlerësoj dhe inkurajoj dukuritë pozitive të shfaqura nga nxënësit gjatë realizimit të ushtrimit. Hapi 3. Mbyllje (20’) Përsëritin kërcimin mbi pengesa të ulëta. Kryhen disa ushtrime për rregullimin e frymëmarrjes. Jepen disa këshilla për mbrojtjen nga gripi. <i>Vlerësimi:</i> Nxënësit do të vlerësohen për: <ul style="list-style-type: none"> • Kryerjen e lëvizjeve të kombinuara të krahëve dhe këmbëve. • Tregimin e gatishmërisë për të ndihmuar të tjerët dhe për të dhënë kontributin personal. 			
<u>Punoi:Aurora PATA</u>			

Fusha : Gjuhe dhe komunikim.

Lenda: Gjuhe shqipe

Shkalla II

Tema mesimore : Tenxherja magjike. (Ora I - lexojme) (Ora II-lexojme)

Rezultatet e te nxenit : Nxenes-i/ja

- Lexon perrallen bukur,rrjedhshem duke dalluar fjalet e reja.
- Komenton ilustrimin e perralles .
- U pergjigjet pyetjeve rreth permbajtjes se perralles.
- Tregon interes dhe deshire per te lexuar.
- Dallon personazhet mbi bazen e veprimeve te tyre ne perralle.
- Tregon permbajtjen e perralles sipas struktures se saj.
- Formulon mesazhin e perralles.
- Interpreton perrallen ne role.

Situata e te nxenit :

- Flasim per sendet dhe objektet magjike ne perralla,tregime,filma per femije.
- Personazhi ne perralle qe me ka terhequr me shume.

Fjale kyce :

- perralle, tenxhere magjike, bluaj, ziej, miell ,memelige,mesazh,deshira.

Burimet dhe materialet didaktike :

- njohurite dhe shkathtesite paraprake te mesuar.
- teksti I nxenesit.
- libra me perralla.
- mjete shkrimi,fletore,lapustila.

Lidhja me fushat e tjera :

-shoqeria dhe mjedisi

-arte

-shkencat e natyres.

Lidhja me temat nderkurrikulare:

-te drejtat e njeriut.

-bashkjetesa paqesore.

Metodologjia : bisede, lexim mendimi i drejtuar, rishikim ne dyshe,trego – argumento,pune ne dyshe,pune individuale,pune me gjithë klasen,loje ne role.

Veprimtarite e nxenesve :

-Veprimtaria I – bisede.

Nxiten nxenesit te flasin per sendet dhe objektet magjike te cilat I kane lexuar ne perralla e tregime apo I kane pare ne filma per femije.

Ndjek me vemendje mendimet e shprehura nga nxenesit.

-Veprimtaria II- lexim dhe mendim i drejtuar.

Prezantoj temen e mesimit dhe e shkruaj ne tabele.

Orientohen nxenesit te vezhgojne ilustrimet ne liber.

Kerkoj nga nxenesit ti pershkruajne me fjalet e tyre dhe t'i komentojne ato.

Lexojne tekstin sipas paragrafeve.Per secilin paragraf nenvizojne fjalet e reja.

U drejtoj pyetje per secilin paragraf.

Ndalesa I.Ishte nje here...deri te...thirri plaka.

Pyetje rreth paragrafit: -Ku shkoi vajza?Perse? –Ke takoi ajo ne pyll? –Cfare I kerkoi plaka asaj?

-Si mendoni, a do t'ia shperbleje plaka miresine vajzes?

Ndalesa II.Ajo mori...deri te...qe te thashe.

Pyetje rreth paragrafit: - Cfare I dha plaka vajzes?

-Cfare mund te bente vajza me tenxheren?

Ndalesa III.Vajza arriti...deri te...nuk ishin me te varfera.

Pyetje rreth paragrafit:-C'beri vajza kur shkoi ne shtepi? –Si po jetonte vajza me nenen e saj,fale tenxheres magjike? –Si mendoni se do te vazhdoje ngjarja?

Ndalesa IV.Nje dite te bukur...deri te...e ta falenderonte.

Pyetje rreth paragrafit:-Ku u kthye vajza?Pse? –Cfare mendoi te bente ajo?

Ndalesa V:Nenen e mori uria...deri te...per fshataret ishte fat.

Pyetje rreth paragrafit:-C'beri nena kur e mori uria? –C'ndodhi me tenxheren?-Ku u perhap mielli? –Pse fshati dhe fshataret ishin me fat?

Ndalesa VI.Ata nisen punen...deri ne fund.

Pyetje rreth paragrafit:-C'bene fshataret per te mbledhur miellin e derdhur ne rruge?-A e falenderuan ata vajzen?Pse? –A ju pelqeu pjesa? –Si ju duket mbyllja e saj?

Lexim zinxhir i perralles.

Diskutim ne dyshe per llojin e tekstit mbi bazen e karakteristikave te tij (perralle).

Veprimtaria III: Trego-argumento.

Nxiten nxenesit te tregojne permbajtjen e perralles sipas struktures se saj.

Analize e personazhit kryesor.

Mesazhi: Nje veprim sado i vogel human, mund te jete pikenisja per nje veper akoma me te madhe bamiresie,ne ndihme te te tjereve.

Nxenesit tregojne raste per perfshirjen e tyre ne pune me karakter humanitar ne shkolle,komunitet.

Veprimtaria IV: Loje me role.

Lexim i perralles me role nga grupe nxenesish me nga 4 nxenes sipas roleve.
(autori,vajza,nena,plaka).

Lexim me ze sipas roleve.

Nxenesit vleresojne interpretimet e njeri-tjetrit.

Dallohet grupi me i mire i intepretimit te perralles.

Vleresohen nxenesit :

-Per leximin e rrjedhshem te perralles.

-Pergjigjet e pyetjeve rreth perralles, ritregimi I permbajtjes se perralles sipas struktures.

-Per dallimin e tekstit dhe personazhet e perralles per nxjerrjen e mesazhit si dhe per lojen me role.

Detyre shtepie : Rubrika ‘Shkruaj’ .

Shkruaj fjalet magjike,te cilave do te deshiroje qe tenxherja t’u pergjigjej.

Paraqit me vizatim personazhin qe te pelqen me shume.

Shkruaj nje mesazh tjeter.

Punuar nga mesuesja : Dukate Uka

Shkurt 2018

Shkolla :17 Shkurti Qesarake

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. 21/02 / 2018

Fusha: Shoq-Mjedisi	Lënda: Histori	Shkalla: V	Klasa: XIA
<p>Tema mësimore: 1)Republika Shqiptare (1925-1928) 2) Monarkia Sqiptare (1928-1939)</p>		<p>Situata e të nxënit:Evidentoni se çfarë kemi mësuar mbi “Statutet Organik të Shqipërisë”. Nga Konferenca e Ambasadorëve në Londër deri në fund kur të mësohet, Statuti i republikës Shqiptare dhe Statuti i Mbretërisë shqiptare. 2) Në historinë e saj Shqipëria ka pasur forma të ndryshme qeverisjeje ndër të cilat edhe mbretëri me anë të një Braistorming të evidentojnë tiparet e Republikës Presidenciale dhe të mbretërisë në Shqipëri.</p>	
<p>Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyce: 1)Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit: Nxënësi:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Shpjegon me gojë dhe me shkrim njohuritë e marra për Republikën Shqiptare dhe Monarkinë Shqiptare gjatë periudhës së Ahmet Zogut.</i> 2. <i>Dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga nxënësit e tjerë dhe mësuesi mbi konceptet kryesore të mësimi</i> <p>2) Kompetenca e të menduarit:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1.<i>Përcakton qartë dhe saktëarsyet pse Zogu në (1925-19280 shpalli si formë regjimi 2Republikë Presidenciale dhe arsyet e kalimit në regjim Monarkik.</i> <p>3) Kompetenca e të nxënit:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Përgatit një album me foto të Ahmet Zogut</i> 2. <i>Përgatit maket të reformave dhe Statutit të monarkisë.</i> <p>4)Kompetencat dixhitale:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Përdor kompjuter, internetin për realizimin e orës së mësimi</i> <p>5) Kompetenca qytetare:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Punon në grup respekton shokët dhe mendimet e të tjerëve</i> 			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave Historike sipas temës mësimore: 1.Arsyeton se pse Zogu vendosi të shpallte si formë regjimi republikën dhe më pas monarkinë Shqiptare. 2.Përshkruani ndërtimin e Republikës, sipas statutit themeltar të saj. 3Analizoni reformat e ndërmarra në fushën e ekonomisë. 4.Analizoni arsyet që eshtynë Zogun të afrohej me Italinë. 5. Analizoni se në çmënyrë krijimi i Bankës Kombëtare të Shqipërisë në vitin 1925, ndikon në</p>		<p>Fjalët kyçe: Republikë Shqipërisë, parlamentare, triumfi i legalitetit, emëtim monedhe, pakte politiko-ushtarake, ratifikim. Reforma Eropianizuese, kodi civil, kodi tregtar, kodi penal, autoritar, stabilitet,libra jashtëshkollor(A. Zogu i B. Fevziut.</p>	

<p>zhvillimin ekonomik të vendit sot.</p> <p>6.Përshkruani kompetencat e mbretit sipas statutit themeltar të mbretërisë.</p> <p>7.Analizon politikën e jashtme në Mbretërinë Zogiste</p> <p>Analizon përmbajtjen e paktit Ballkanik</p> <p>Analizon se në çmënyrë baza ligjore e monarkisë ndikon në integrimin rajonal dhe europian të Shqipërisë sot.</p>	
---	--

<p>Burimet: Teksti i nxënësit, materiale nga interneti, tabela, ese foto.</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Historia e Qytetërimit, TIK, Gjuhë-Komunikim, Gjeografi</p>
--	---

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve PNP (Stuhi mendimesh Diag Veni, Punë në grupe, Organizues grafik i informac, 5 vargëshi)

Organizimi i orës së mësimi:Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve për orën e parë:

Fazat	Strategjitë	Veprimtaritë	Organizimi
Parashikimi	1Brainstorming,Parashtrim me terma paraprake. 2Debat	Diskutim i ideve	
Ndërtimi i njohurive	1Punë në grupe 2Organizuesi grafik 3Debat	Të nxënët bashkëveprues	
Përforcimi	1Diagrama e venit 2Ese	Mësojmë përmes lojës.	

Parashikimi i njohurive:Stuhi mendimi, parashtrimi me terma paraprake
 Gjatë kësaj etape unë shkruaj termat: Republikë , Ahmet Zogu, Monarkia dhe nxënësit shkruajnë poshtë cdo etikete fishat atë cka ata dinë.
 Më ps ndërtohet një tabelë ku unë shkruaj ngjarjet historike sipas kronologjisë dhe ata japin përgjigjet e tyre.20 min

Statute	Koha	Forma e Qeverisjes	Kryetari i shtetit Funkcionet
Statuti organik i Shqipërisë ligji themeltar (kushtetuta)	10 prill 1914	Principatë kushtetuese e pavarur dhe e trashëgueshme nën garancinë e Fuqive të	Princ Vidi Asambleja Kombëtare kontrollohej nga

Konferenca e Ambasadorëve në Londër		Mëdha(monarki) Organi legjislativ Asambleja Kombëtare kontrollohej nga princi	Princi Gjuha në shkolla Shqipja Ndarja administrative Përcaktimi i institucioneve të shtetit, përbërjen e forcave të armatosura Njohja e pronës. Shpallja e shtetit të pavarur.
Statuti i Lushnjës (kushtetutë e përkohshme	31 janar 1920	Forma monarkisë së përkohshme.Këshillin e lartë prej 4-vetësh, që përfaqësonte kryetarin e shtetit, deri sa të ërfundonte forma e regjimit e Asamblesë Kushtetuese. Këshilli Kombëtar që quhej Senati i përbërë nga 37 anëtarësh	
Republika Shqiptare(1925)	Mars 1925	Republikë Parlamentare Presidenciale	President Ahmet Zogu
Monarkia Shqiptare (1928-1939)	1928—1939	Mbretëri Demokratike Parlamentare e Trashëgueshme A. Zogu mbreti i shqiptarëve	Mbreti A.Zogu

Ndërtimi i njohurive:Klasa ndahet në dy grupe(Diskutim i ideve-punë në Grupe,Harta e koncepteve.25min

Grupi I Republika Shqiptare

Grupi II Monarkia Shqiptare


Brenda grupit nxënësit ndërtojnë minigrupe në të vogla.30min

Udhëzohen nxënësit të lexojnë tekstin ndërkohë unë shkruaj disa nga çështjet kryesore që janë për tu shpjeguar

Gr I Republika Shqiptare	Grupi II Monarkia Shqiptare
Kur e si u shpall Republika Shqiptare, Mbretëria	Kur e në crethana u shpall
Sfidat e Zogut si president, organizimi i saj i	Statutet Themelor i Mbretërisë

brendshëm	
Marrëdhëniet e shtetit shqitar me jashtë	Masat që ndërmoi A.Zogu për zhvillimin e jetës shoqërore shqiptare pengesa që hasi. Marrëdhëniet Italo-Shqiptare 1928-39

Përforcimi (Diagrama e Venit) 10 min



Nxënësit japin mendimet e tyre dhe më pas i diskutojmë

Në klasë ndërtohet një diagram veni. Une paraqes me skeda mësimin dhe secili grup mban qëndrimin ose të përbashkëtat e Monarkisë dhe Republikës së Shqipërisë dhe të vecantat kështu nxënësit mësojnë nëpërmjet lojës.

Konceptet nëpërmjet debateve:15 min

Klasa ndahet në 2 grupet dhe secili grup qëndrimin e tij pro ose kundër Republikës dhe Monarkisë së Zogut.

Unë si mësuese nxis debatin me termat dhe situatat e krijuara

Përforcim: Ese Nxënësit hartojnë një ese (përshkruese, analizuese) mbi figurën e A. Zogut me termat paraprake të dhëna, disa nga esetë lezohen dhe diskutohen

Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit për punën individuale, në grupe, (për dëgjimin interpretimin, ndarjen e përvojave etj

Detyra: Realizimi i një albumi me materiale nga interneti mbi forma mbresëlënëse fotosh të figurës së Ahmet Zogut.

Punoi:Etleva Gata

Domaine: Langues et communication	Matière: Français	Niveau: V	Classe : 11-è
Thème : 1- Formuler des hypothèses. 2- Les phrases hypothétiques		Situation de l'acquis: Concevoir des hypothèses	
<p>Les résultats de l'acquis selon les compétences clés : 1-Communiquer et s'exprimer.(L'élève présente devant les autres un projet sur un thème donné en liant les formes de la communication et la pratique). 2- Apprendre. (L'élève utilise des techniques pour gérer et appliquer les formules des hypothèses). 3- Compétence personnelle. (L'élève collabore avec les autres pour les activités en classe. 4- Réfléchir. (L'élève élabore ses idées par écrit , les présente selon un raisonnement et justifie ses choix concernant une activité)</p>			
<p>Les résultats de l'acquis des compétences de la domaine selon le thème : À l'issue de cette séance du cours l'élève :</p> <ol style="list-style-type: none"> 1- Conjugue un verbe du premier groupe au conditionnel présent. 2- Fait des phrases utilisant le conditionnel présent / passé en utilisant les formules des hypothèses. 3- Utilise le conditionnel pour des situations hypothétiques. 		<p>Mots clés:</p> <p>hypothèse , condition, réalisation , formule , science .</p>	
<p>Sources : Manuel de français , Cahier d'exercices,Internet , DVD, Infos, video-projecteur, fiches en images , fiches en couleurs, etc .</p>		<p>L'éventuelle liaison avec les autres domaines :</p> <p>La langue albanaise (grammaire).</p> <p>La sociologie (la situation de la femme dans la société)</p>	
Méthodologie et activités des élèves :			
Les phases de la structure	Méthodes de l'enseignement	Les activités	
Prévision: 20 min	Remue-méninges , Expression libre	Développement du vocabulaire ,expression libre .	
Construction de connaissances: 25 min	Analyser et pratiquer , Pas à pas	Présentation structuré du nouveau matériel.	
Renforcement: 30 min	Travail en binômes/ en petits groupes , Prévision avec des termes préalables	La pédagogie coopérative , travail en groupes.	

❖ **Organisation de la séance : PRÉVISION 20 min.:** Faire le contrôle des devoirs à la maison . 2- 3 élèves présentent leurs travaux . Discuter les questions sur les devoirs s'il y en a.


Écrire au tableau le thème du cours. L'hypothèse se réfère au mode conditionnel .

Remue-méninges : a- Quel est la racine du mot "conditionnel" ?

b- Que fait-on pour réaliser une condition ?

c- Écrivez trois mots qui vous viennent à l'esprit .

❖ **LA CONSTRUCTION DES NOUVELLES CONNAISSANCES 25 min.**



Premier pas : Le conditionnel présent se forme avec la racine du futur + les terminaisons de l'imparfait (-ais , -ais , -ait , - ions , -iez , aient)

Ex. Parler

Je parler-**ais** Nous parler-**ions**

Tu parler-**ais** Vous parler-**iez**

Il / Elle parler-**ait** Ils/Elles parler-**aient**

Deuxième pas : Le conditionnel passé se forme avec l'auxiliaire "**avoir**" ou "**être**" au conditionnel présent + le participe passé du verbe à conjuguer .

Ex. Acheter

Partir

J'aurais acheté

Je serais parti(**e**)

Tu aurais acheté

Tu serais parti(**e**)

Il / Elle aurait acheté

Il serait parti

Nous aurions acheté

Elle serait partie

Vous auriez acheté

Nous serions parti (**e**)s

Ils / Elles auraient acheté

Vous seriez parti(**e**)s

Ils seraient partis

Elles seraient parties

Troisième pas : Faire des hypothèses au présent / au passé. Formules :

- Si + présent → Présent (futur) de l'indicatif .
Ex. Si je **gagne** au Loto , **j'achète (j'achèterai)** une nouvelle voiture .
- Si + imparfait → Conditionnel présent.
Ex. Si je **gagnais** au Loto **j'achèterais** une nouvelle voiture .
- Si + plus que parfait → Conditionnel passé.
Ex. Si **j'avais gagné** au Loto **j'aurais acheté** une nouvelle voiture .

❖ **RENFORCEMENT DES CONNAISSANCES 30 min.**

Travail individuel et en petits groupes .

Fiches : 1- Conjuguez les verbes ; Danser / Aller au conditionnel présent .

2- Conjuguez au conditionnel passé les verbes ; Venir / Visiter .

3-Travail avec le livre : exercice 6, 7, 8, 9, page 81.

4- Pédagogie coopérative : Avec le voisin faites des phrases hypothétiques en les associant avec des dessins .

5- Fiches en images : ex. Si je suis une grenouille à grande bouche (faire des hypothèses)

6- Présenter une situation hypothétique (ex. vivre dans une île déserte). Utilisez le conditionnel

Évaluation 10 min : Évaluation diagnostique. On évalue les élèves selon leur réponses, la collaboration avec ses voisins , le travail individuel ou le travail à deux .

Note 5/6 = niveau 2 (Les élèves qui identifient les formules des hypothèses) . Note 7/8 = niveau 3 (Les élèves qui utilisent des techniques pour gérer et employer les formules des hypothèses). Note 9/10 = niveau 4 (L'élève qui élabore ses idées par écrit , les présente selon un raisonnement et justifie ses choix dans les activités).

Les devoirs et le travail indépendant des élèves 5 min : Exercice 10 page 81 / exercice 3 page 83 .

Tematika :Thyesat,numrat dhjetore dhe perqindjet

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE (Platforma e re)

Dt. / /

Fusha: Matematike	Lënda: Matematike	Shkalla: V	Klasa: X Ora:
Tema mësimore 1.1: Thyesat dhe perqindjet (aftesi) Tema mësimore 1.2: Thyesat dhe perqindjet (zbatim)		Situata e të nxënit: Ndarja e objekteve ne raporte te ndryshme Notat ne provimete e ndryshme ,numri i banoreve ne nje qytet, Ndarja e pasurise ndermjet nje numri te caktuat personash perfitues. Rendesia e perpnimit te te dhenave me ane te numrave dhjetore. Modelim ndarjesh dhe pasqyrimesh mbi numrat e kategorise se me siperme dhe nepermjet projektit perfundimtar ne kete periudhe te vitit shkollor.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç: <ul style="list-style-type: none">• kthen thyesen ne numer dhjetor dhe ne perqindje dhe anasjelltas• kthen numrat dhjetore te pafundem ne thyesa• krahason ndermjet tyre numra te shprehur ne menyra te ndryshme• krahason dhe rendit numra dhjetore dhe periodike te shprehura ne menyra te vecanta			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: <ul style="list-style-type: none">• vlerëson rëndësinë e perdorimit te numrave dhjetore ,periodike dhe ato me perqindje• njeh rregullat e veprimeve dhe i zbaton ato.		Fjalët kyç: Numra dhjetore,numra dhjetore te fundem,numra dhjetore te pafundem,perqindje.	
Burimet: Libri mësimor, makina llogaritese.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurikulare: shkence	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: mësimdhënie e drejtpërdrejtë.			

Organizimi i orës së mësimi (tema e 1)

Parashikimi i njohurive: Mesuesja kërkon që nxënësit të shkruajnë si thyesë numrat $0,4$; $0,15$; $1,6$; 2 ; $0,0015$ nxënës të ndryshëm tregojnë zgjidhjet e tyre në tabele.

Ndertimi i njohurive: Mesuesja kërkon që nxënësit të kujtojnë mënyrën e shkrimit të numrave të pafundem periodike me ndihmën e simboleve konkretisht a) $0,13$

Nxënësit punojnë në dyshë shembullin 1

Mesuesja kërkon që nxënësit të evidentojnë rezultatin e pjestimit mbi të cilin do të formulohet perfundimi i ushtrimit. Ata vëjnë re se pjestimi i parë del numer i fundem ndërsa i dyti periodik.

Mesuesja tregon si lexohet numri dhjetor si përqindje. Formulohet në trajtë rregull të mënyra se si dallohet pa kryer pjestimin, thyesa që prodhon numer dhjetor të fundem nga ajo që jep numer të pafundem periodik. Punohet shembulli dytë i tekstit.

Nxënësit në dyshë punojnë shembullin e tretë në faqen 92. Pasi janë bërë kthimet e kërkuara këmbehen zgjidhjet ndërmjet dyshëve dhe behen krahasimet. Dyshet që mbarojnë punojnë ushtrimin katër, disa e prezantojnë zgjidhjen në tabele.

Perforcimi i të nxënësve: dyshet e nxënësve punojnë ushtrimet 2, 7, 14 në faqen 93. Pasi perfundojnë këmbejnë zgjidhjet e tyre ose i diskutojnë në tabele ku argumentohet pse ndodh kjo, ata janë në gjendje të vëtvlerësohen dhe të vlerësojnë të tjerët.

Vlerësimi: mesuesja mban shënim në evidenncë vlerimin e disa prej nxënësve lidhur me saktësinë në njehsimin pjesës, argumentimin e veprimeve dhe saktësinë e gjetjes së rezultatit të kërkuar.

Detyra: ushtrimet 4, 8, 13 në faqen 93 me udhëzimet përkatëse. Ushtrimet 16, 17 lihen me dëshirë.

Organizimi i orës së mësimi (tema e 2)

Parashikimi i njohurive: Mesuesja kërkon që nxënësit të rikujtojnë si shkruhet numri dhjetor dhe përqindja si thyesë ndërmjet punës në dyshë. Ktheni në thyesa numrat : a) 24% ; b) $1,5$; c) $0,5$

Kontrollohet rezultatet e gjetura dhe për çdo rast argumentohet shërrimi në tabele.

Ndertimi i njohurive:

Mesuesja kërkon që nxënësit të kujtojnë hapat që duhet të ndjekin gjatë zgjidhjes së një probleme me thyesat, numrat dhjetorë, përqindjet. Me pas punohet situata e shembullit të parë në faqen 94. Pasi nxënësit njihen me të dhënat e problemeve kthehen rezultatit të parësiveve në përqindje dhe njehsojnë ndryshesat B-D dhe A-C. Pasi tregojnë përgjigjen e sakte mesuesi nxit diskutimin duke shtruar pyetjen: - A mund të zgjidhej problema duke bërë kthimin në thyesë dhe jo në përqindje? Po njësor veprohet për shembullin 2 në këto faqe. Mesuesja pyet si do të kryenit veprimet me numra periodike? Dyshet e nxënësve japin mendimin e tyre dhe arrihet në një perfundim.

Me pas dyshet bashkohen në katërshë dhe punohet shembulli tre në këto faqe 94

Perforcimi i të nxënësve: Klasa e ndarë në grupe punon ushtrimin 2 faqe 95, grupet e njëjta bëjnë krahasimin rezultatëve. Grupet e nxënësve vazhdojnë zgjidhjet edhe me ushtrimin 4 dhe 5, duke argumentuar zgjidhjen dhe modelimin e secilës pjesë të zgjidhjeve

Argumenti i zgjidhjes ka shumë rëndësi. Grupet mund të plotësojnë zgjidhjen e njëra-tjetres. Gjatë prezantimit dhe argumentimit të zgjidhjeve.

Vlerësimi: Mesuesja mban shënim në evidence për vlerësimin e disa prej nxënësve lidhur me zoterimin e rezultatëve të të nxënësve të parashikuara për këto teme, duke u mbështetur në punën e nxënësve në fletore apo në aktivizimin e tyre në tabele. Duke qenë se në klase punohet me grupe mesuesja merr parasysh edhe vlerësimin e nxënësve nga nxënësi.


Detyra : Problemat 1, 5, 6 faqe 95. Ushtrimi 10 faqe 95 lihet me dëshirë të nxënësve. Mesuesja udhëzon nxënësit për zgjidhjen e tyre.


LIBRI I MATEMATIKES 10/ Shtëpia botuese

PEGI(S.Fearnley;J.Haigton;P.Mullarkey;J.Nicholson;M.Nixon)

Punoi mesuesja FLORA DULE (shkolla MB 'A.Bardhi' Farke 2018.

Fusha Matematikë	Lënda Matematikë	Shkalla II	Klasa e tretë
Tema mësimore: Ora 1-Tabela e shumëzimit. Ora 2-Zbatime të shumëzimit		Situata e të nxënët: ❖ 1-Si veprojmë për të mesuar shumëzimet ? ❖ 2-Plotesim tabelash . diagramesh . bosht numerik Situata problemore	
Rezultatet e të nxënët të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: <ul style="list-style-type: none"> • <i>Plotëson tabelën e shumëzimit deri në 10.</i> • <i>Përcakton vetitë dhe kufizat e shumëzimit.</i> • <i>Dallon fjalitë që përdoren në shumëzim.</i> • <i>Përcakton faktorët kur është dhënë prodhimi dhe anasjelltas.</i> • <i>Zbaton shumëzimin në tabela, operatorë, diagramë, bosht numerik dhe problema.</i> • <i>Përcakton numrat që e bëjnë të vërtetë një barazim ose mosbarazim me x.</i> • <i>Krijon problema me zbatimin e shumëzimit</i> 			Fjalët kyçe: shumëzimi, numër rreshtash, numër shtyllash, shumëfish, rregull, faktor, prodhim, veti, tabelë shumëzimi. Zbatim shumëzimi, tabela, operatorë, diagramë, bosht
Burimet: Libri i nxënësit. • Sende të ndryshme për grupime. Ngjyra • Modele demonstruese për mësuesin.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat nderkurikulare Art, Gjuha dhe komunikimi, Edukim fizik	
Metodologjia, teknikat e përdorura, veprimtaritë e nxënësve. Mendo - diskuto - nxirr përfundimin. Të punuarit në bashkëpunim. Puna në grupe Rishikim dyshe Pune individuale - Krijim i lirë.			
Faza e parë: diskuto-nxirr përfundimin. Per te e realizuar ketem faze mesuesi kijon disa situata : Situata 1: Ndan klasën në 5 grupe dhe secili grup do të përcaktojë prodhimin me një faktor, në fillim nga 1-5, pastaj me faktorët 6-10 Të gjitha prodhimet ngjiten në tabelën e shumëzimit të përgatitur nga mësuesja. Situata 2: Janë shkruar disa fisha dhe nxënësit do të zbulojnë fishat që i takojnë shumëzimit. P.sh. Shumëzimi zëvendëson mbledhjen e përsëritur. Shumëzimi kryhet gjithmonë. Numrat që shumëzohen quhen faktor Situata 3: Mësuesja vendos etiketat me fjalët prodhim, faktor, faktor. Per cdo cift nxenes do te shperndahen fisha me shembujsh ushtrimesh me veprim x dhe nxenesit pasi e kane diskutuar ne cift e plotesojne. Ngre nxënës që të marrë dy faktorë psh 6,8 nxënësi tjetër të vendosë prodhimin 48. Anasjelltas.Nxënësi merr një prodhim të një numri të caktuar.psh.63. Nxënësi tjetër merr dy faktorët që japin këtë prodhim etj..... Faza e dyte: Te punuarit ne bashkepunim. Pune ne çift. Nxënësit kryejne veprimtari në liber: 1.Plotësojnë tabelën e shumëzimit. 2.Qarkojnë pohimet e vërteta për shumëzimin. 3.Përcaktojnë faktorët që japin prodhimet e vërteta. .4.Zbaton shumëzimin në operatorë, diagrama, situata problemore. Për secilin plotësim nxënësit diskutojnë ne çift Faza e trete: Demonstrim dhe prezantim i rezultateve te arritura Pune individuale Kerkohet nga nxenesit qe ta paraqesin me barazime nje nga tabelat , të krijojnë nje problemë me shumëzim dhe ta paraqesë atë të paktën në dy mënyra. Prezantim i pune se tyre para klases ngga disa nenes ne varesi te kohes Bëhet vlerësimi i punës në mënyrë të vazhduar nga mësuesja.			
Vlerësimi i nxënësve. Nxënësit vlerësohen për përqëndrimin e tyre gjatë orës se mësimi. Për diskutimin dhe dhënien e ideve të tij në mësim. Për të punuarit e tyre në grup dhe individualisht. Detyrat e dhëna për punë të pavarur: 1-Nxënësit do të plotësojnë fletoren e punës dhe do të paraqesin me tabele ose diagram 5 veprime me shumëzime 2- një problemë me prodhimet e mësuara.			

Fusha Gjuhët dhe komunikimi	Lënda Gjuha shqipe	Shkalla II	Klasa e tretë
Tema mësimore: 1- Lexim jashtë klase perralla “Tre vellezerit dhe deti”. 2- Diktim		Situata e të nxënit: ❖ Leximi i librave jashtë klase ❖ Shkrimi i një pjese me të diktuar.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: ♦ Lexon përrallën duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe fjalitë që i pëlqejnë ♦ U përgjigjet pyetjeve rreth përmbajtjes së përrallës; ♦ Përcakton dy-tri tipare të përrallës ♦ Tregon përmbajtjen e përrallës sipas strukturës së saj; ♦ Formulon mesazhin që përcjell fabula; ♦ Përshkruan me fjalë të thjeshta personazhet dhe tregon se cilët janë personazhet e preferuara ♦ Shfaq besim dhe vullnet në forcat vetjake për të fituar rrjedhshmërinë e duhur gjatë leximit ♦ Shkruan një tekst me të diktuar; ♦ Përdor shenjat e pikësimit (pikë dhe pikëpyetje në fund të fjalisë); ♦ Përdor drejt shkronjën e madhe në fillim të fjalisë; ♦ Përdor drejt shkronjën e madhe për emrat e përveçëm; ndan saktë fjalët në fund të rreshtit ♦ Bën qortime të thjeshta drejtshkrimore me ndihmën e mësueses.			Fjalët kyçe <i>Lexim jashtë klase</i> <i>Napaskesh qene , kushte .</i> <i>drejtshkrim, diktim, shkronjë</i> <i>e madhe, shenjë</i> <i>pikësimit, ndarje në fund të</i> <i>rreshtit. vetediktim</i>
Burimet: libra jashtë klase ,mjete vizatimi . fletorja e diktimit , mjete shkrimi		Lidhja me fushat e tjera ose me temat nderkurikulare : Artet Shoqëria dhe mjedisi	
Metodologjia, teknikat e përdorura, veprimtaritë e nxënësve:. stuhi mendimesh; Lexim i drejtuar ,Harta e koncepteve - diskutim; Vizatim Rikujtim njohurish punë individuale Shkrim.			
<p>Veprimtaria e 1: -Stuhi mendimesh</p> <p>Mësuesja paraqet pamje të ndryshme të deti dhe nisur nga fjalet e tiullit nxenesit do te japin mendime per “Detin”. Mendimet e tyre nxënësit/et të flasin se çfarë dinë për detin. Përgjigjet e tyre i paraqet në tabelë.</p> <p>Prezantimi i titullit të perralles dhe autor.i</p>  <pre> graph TD Deti((Deti)) --> i_madh[i madh] Deti --> mesojme_notin[mesojme notin] Deti --> i_dashur_per_te_gjithë_femijet[i dashur per te gjithë femijet] Deti --> i_kalter[i kalter] Deti --> Q1[?] </pre> <p>Veprimtaria e 2 : Lexim i drejtuar</p> <ul style="list-style-type: none"> -Leximi i pjeses ne heshtje per 5 min duke nenvizuar fjalet e reja -Tregohet për llojin e pjesës me 2-3 karakteristika -Shpjegim i fjaleve te reja duke formuar dhe fjali me to -Tregohet permbajtja e perrales sipas struktures se saj. <p>Veprimtaria e 3: Harta e koncepteve -Diskutim</p> <p>Analizohen personazhet duke ilustruar cilesite me fjalite perkatese te tekstit.</p>			



Lexim i përralles zinxhir dhe me role (Deti .Beni .Denisi dhe Artani)

Mesazhi që përcjell pjesa.

Komenti i fragmentit që pëlqejnë më shumë.

Lidhja e këtij mesazhi me jetën e tyre.

Ilustrim i pjesës me vizatim.

ORA E DYTE - Veprimtaria 5: Rikujtim njohurish

Mësuesi/ja fton nxënësit/et për të treguar rregullat drejtshkrimore që dinë (ndarja e fjalëve në fund të rreshtit, fillimi i fjalisë me shkronjë të madhe, shenjat e pikësimit në fund të fjalisë, shkronja e madhe për emrat e përveçëm).

Lexim i pjesese që do të diktohet **“Tre vellezerit dhe deti”**

Veprimtaria e 6 : Diktim - Shkrim

Mësuesi/ja dikton pjesën. **“Tre vellezerit dhe deti”** nxënësit shkruajnë

Rilexim i pjeses pasi ka perfunduar diktimi

Bëhet korrigjimi i diktimit me ndihmën e mësuesit/es.

Vlersimi me kod duke e argumentuar atë

Qortohen gabimet e bëra duke i shkruar përsëri saktë.

Vlerësimi bëhet për: leximin përrallës nga folklori,

- përcaktimin e dy-tri tipareve të përralles
- përshkrimin me fjalë të thjeshta të personazheve
- tregimin interes dhe dëshirë për të lexuar;
- ndarjen me të tjerët të përvojave të tij/saj rreth leximit;
- shkrimin e tekstit me të diktuar;
- përdorimin e shenjave të pikësimit (pikë dhe pikëpyetje në fund të fjalisë);
- përdorimin e drejtë të shkronjës së madhe në fillim të fjalisë;
- përdorimin e drejtë të shkronjës së madhe për emrat e përveçëm;
- ndarjen saktë të fjalëve në fund të rreshtit;

Detyrat - Pesevargesh “Deti”

- Meso 5-6 fjali nga perralla **“Deti”** dhe realizo vetediktim

Fusha:Gjuha dhe komunikimi	Lenda:Gjuha shqipe	Shkalla:III	Klasa:VI-A
Tema mesimore: Kopraci		Situata e te nxenit:Lexojme komedi	
Rezultatet e te nxenit te kompetencave te fushes sipas temes mesimore:Nxenesi: -lexon fragmentin per te zberthyer permbajtjen e tij -pershkruan gjendjen shpirtore te personazhit -diskuton rreth reagimit te Harpagonit -analizon gjuhen e tekstit duke gjetur figura letrare -komenton fragmente,thenie te Getes,La Fontenit		Fjalet kyc: -komedi -humor -personazh -ves,koprac -tipare -gjendje shpirtore	
Burimet: Teksti I nxenesit, materiale te pergatitura nga mesuesja		Lidhja me fushat e tjera ose me temat nderkurrikulare: Artet Shoqeria dhe mjedisi	
Metodologjia dhe veprimtarite e nxenesve: stuhi mendimi,pesevargesh,diskutim pune e pavarur,koment			
Organizimi I ores se mesimit:		Situata paraprake	
Kujtojme njohurite e marra per gjinine dramatike:Drejttoj pyetjen:C' dini per tekstin dramatik ne pergjithesi?Po per komedine?			
<pre> graph TD K((Komedia)) --> A(Shigjeton vese,te meta te shoqerise nepermjet humorit) K --> B(Shkruhet per t'u vene ne) K --> C(Ndertohet ne forme monologu.dialogu.diaskal) K --> D(Ndahet ne akte dhe skena) </pre>			
Zhvillimi I situates: Kerkoj nga nxenesit qe te ndertojne nje pesevargesh per fjalen <u>kopraci</u> . -Informoj shkurtimisht nxenesit per autorin dhe per vepren e tij.Shpjegoj me shembuj figuren e <u>simbolit</u> . -Lexim me role.(perzgjedh dy nxenes) -Shpjegimi I fjaleve te panjohura.			
Pyetje per te zberthyer permbajtjen e pjeses: Ku zhvillohet ngjarja? Cfare e ka tronditur dhe alarmuar Harpagonin?			

Ku dyshoi Harpagoni?

C'masa kerkon te marre ai per gjetjen e hajdutit?

Cfare zotohet se do te beje komisari?

Cila eshte shuma e parave qe I kane vjedhur Harpagonit?

Cfare kerkese I ben Harpagoni hetuesit?

Cfare keshille I jep komisari?

Ora II: Punojme rubriken Inetrpretojme tekstin

-Cilin ves denon autori ne kete komedi?

-Si eshte gjendja shpirteroe e Harpagonit?A e justifikoni ate? (Diskutim)

Analizojme tekstin:Zbuloni tipare komike dhe tragjike te Harpagonit si personazh? (pune e pavarur)

Lexoni monologun e Harpagonit dhe renditni mendimet e tij.

Analizojme gjuhen e tekstit:Pjesa e pare e fragmentit dallon:

-per pyetjet retorike

-per pyetjet e perseritura

-per frazat e shkurta

-per fjalite urdherore

Ilustroni me fjali nga teksti per secilin rast.

Gjeni epitete dhe metafora qe autori perdor per parane ne monologun e Harpagonit.Percaktoni c'pjese ligjerate jane.

Reflektojme rreth tekstit:Komentoni theniet e meposhtme:

Kopraci humbet cdo gje nga lakmia per te pasur gjithcka.

La Fonten

Te varfrit I mungojne shume gjera,kopracit I mungon gjithcka.

Gete

Vleresimi:Per perfshirjen ne mesim ,per pergjigjet e sakta dhe te argumentuara,per qendrueshmerine e njohurive.

Detyrat dhe puna e pavarur: Mesoni permendsh nje pjese te monologut te Harpagonit.



ABETARE

Tema mësimore: Shkronja Dh
Punimi i faqes 66 të abetares.



Rezultatet e të nxënimit:

- Dallon dhe e shqipton tingullin **Dh**
- Lexon saktë shkronjat fjalë e fjali
- Thotë fjalë me shkronjën **Dh** dhe analizon fjalë.

Borëbardha



Shqiptimi i shkronjës Dh

Dh ,dh

Dh dh

D + h = Dh

Fjalë kyçe:


Borëbardha



Dhurata



Dhelpra



Dhjetë



Dhia



Dhjetori

	«	Dhjetor 2018						»	
	Ha	Ma	Mr	Ej	Pr	Sh	D		
48						1	2		
49	3	4	5	6	7	8	9		
50	10	11	12	13	14	15	16		
51	17	18	19	20	21	22	23		
52	24	25	26	27	28	29	30		
1	31								

- **Lidhja me fusha të tjera :**
Art Pamor , dituri natyre , matematikë

Burimet dhe materialet didaktike :

- Teksti i nxënësit
- Foto me fjalë
- Shkronja lëvizore

Metodologjia :

- Shqiptim
- Lexim
- Analizë
- Punë me tekstin

Hapi i parë

Kujtojmë shkronjat e mësuara

- Çfarë shihni në figurë ? Borëbardha
- Kush më dallon shkronjën **Dh** tek fjala Borëbard**ha**

Shqiptimi i shkronjës **Dh**

- Leximi i shkronjave **Dh** ,dh / *Dh dh*
- Thonë fjalë të ndryshme me tingullin **Dh**

Hapi i dytë

Punë e drejtuar me tekstin

- Lexim nga mësuesi – lexim nga nxënësit .
- Analizë e fjalëve në rrokje, fjalisë në fjalë e rrokje.
- Shkronja dh është përbërë

formohet nga $d+h=dh$

Dhelpra/**dhel-pra** , dhia/**dhi-a** , dhurata/**dhu-ra-ta**

- Borëbardhës i dhanë dhuratë.

Fjalja ka **3 fjalë** dhe **9 rrokje** .

Hapi i tretë

Plotësohen fjalët me shkronjat që mungojnë.

- **Dhje** të , **dhel** pra , **dhu** rata
- Ndjek punën e nxënësve , lexojnë me zë fjalët e plotësuara .

Detyra :

Shkruani nga dy rreshta me **Dh** , **dh**

Shkruani dhjetë fjalë dhe një fjali .

Punoi: Majlinda Dosti

Shkolla: 17 Shkurti Qesarake

(orën e parë nxënësi njihet me poetin, krijimtarinë poezinë dhe orën e dytë analizon poezinë)

Planifikimi ditor i orës së mësimit sipas kurrikulës me kompetenca

Fusha :Gjuha dhe komunikimi

Lënda:Gjuhë shqipe

Shkalla:III

Klasa:VII

Tema mësimore:Atdhe-poezi (TEODOR KEKO) (2 orë)

Situata e të nxënit: Poezi për atdheun nga poetë shqiptarë

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:

1. *Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit.*
2. *Kompetenca e të menduarit.*
3. *Kompetenca personale*

REZULTATET E TË NXËNIT TË KOMPETENCAVE TË FUSHËS SIPAS TEMËS:NXËNËSI

-KUJTON POEZI,VARGJE PËR ATDHEUN NGA POETË SHQIPTARË .

-PLOTËSON ME PËRKUFIZIME TOGFJALËSHIN "ATDHEU ËSHTË;".

-LEXON POEZINË PËR TË KUPTUAR MESAZHIN,TEMËN.

-ANALIZON POEZINË,STROFAT,VARGJET.

-SHKRUAN NJË PESËVARGËSH PËR ATDHEUN.

Fjalë kyçe: Athde,i dhembshur, pranverë mahnitëse,vendi im,breza,dashuri.

Burime,mjete,materiale:Teksti "Gjuha shqipe 7",fleta formati,tabela,videoprojektor,laptop,hartë, informacion për autorin, poezi.

Metoda dhe teknika:Stuhi mendimesh, Punë e drejtuar,Ditari dypjesësh,Punë me grupe,Pesëvargëshi

Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shoqëria dhe mjedisi-Historia,Artet

Organizimi i orës:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme: Stuhi mendimesh

Nxiten nxënësit të kujtojnë poezi, vargje për atdheun të mësuar dhe të plotësojnë kllasterin me përkufizime.



Ndërtimi i njohurive të reja: Punë e drejtuar, Ditari dypjesësh

-Lexohet poezia, informacion rreth autorit. Punohen fjalët e rubrikës fjalor.

-Kalohet në rubrikën "Studim teksti", pyetje rreth poezisë. -Kujt i kushtohet

poezia? Shprehje optimiste të poetit në poezi. Zgjeroni me fjalët tuaja mendimin: " Ne ty apo ti na zgjat neve jetën?"

Punë me grupe: Analizojmë poezinë

Grupi I: Zbuloni si e ka himnizuar natyrën poeti në strofën e parë?

Grupi II: Shpjegoni kuptimin e strofës së dytë duke nxjerrë në pah mesazhet që vijnë nga historia.

Grupi III: Përshkruani ndjenjën e lartë të poetit në strofën e tretë. Me se lidhet ajo?

Ditari dypjesësh:

Fragmenti/vargu	Komenti
Vendi im, një ulli përjetësisht i gjelbër	

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: Punë dyshe, Pesëvargëshi

Nxënësit shkruajnë një pesëvargësh për "Atdheun"

Atdhe

[] []


[] [] []

[]

Nxënësit prezantojnë punën.

Mesazhi i poezisë:

Lidhja me fushat e tjera: Shoqëria dhe mjedisi, Historia, Artet, Muzika



Vlerësimi i nxënësve për angazhimin, saktësinë e përgjigjeve të nivelit kuptimor, analizën, interpretimin, shpjegimin e frazave të përdorura nga autori në këtë poezi, si dhe reflektimin rreth temës.

Detyrë: Shkrim i lirë (prozë, poezi, ese, përshkrim), me temë "Atdheu im"

PUNOI :MANILA KACA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT SPORTIT DHE RINISË
DREJTORIA ARSIMORE RAJONALE E QARJUT TIRANE
SHKOLLA 9-VJEÇARE “MEZEZ-FUSHE”

PLAN DITAR

Në zbatim të nismës “Tri lëndë në gjashtë orë”

Fusha:Gjuha dhe komunikimi **Lenda:** Gjuhe shqipe Shkalla II Klasa III
Ora 1+ 2

Tema mesimore :Gjethja e pemës ,era ,rrezet e diellit . (2 orë)

Situata e të nxenit : Je në një vend ku ke gjithçka për të jetuar por të mungojnë gjërat .Si do të ndihesh ?

Fjalë kyçe : gjethja e pemës,era,rrezet e diellit ,shushurijne ,gdiu ,rane pingul .

Rezultatet e të nxenit :

Lexon tekstin duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe shprehjet që i pëlqejnë më shumë .

Tregon kuptimin e fjalëve të reja duke i përdorur në kontekste të tjera .

Tregon llojin e tekstit duke u bazuar në karakteristikat e tij.

U përgjigjet saktë pyetjeve rreth përmbajtjes së tekstit të lexuar.

Tregon përmbajtjen e tekstit sipas strukturës së tij dhe rrjedhës së ngjarjes të paraqitur në tekstin e lexuar .

Mban qëndrim ndaj veprimeve të personazheve duke dhënë mendimin e tij .

Jep gjykimin e tij /saj në lidhje me temën që trajton tregimi duke e shoqëruar me fakte konkrete .

Shfaq besim në forcat vetjake për të fituar rrjedhshmerinë e duhur gjatë leximit .

Komunikon lirshëm mendimet e tij /saj në lidhje me pjesën e lexuar .

Dallon cilësitë e personazheve duke u mbështetur tek veprimet që ata kryejnë në tregim.

Interpreton në role ngjarjen e lexuar duke respektuar natyrën e personazhit që përfaqëson .

Shpreh mendimin e tij në lidhje me mbylljen e historisë së lexuar duke e argumentuar atë .

Vlerëson punën e tij dhe të shokëve duke e argumentuar me fakte vlerësimin e bërë .

Burimet dhe materialet didaktike : Njohuritë dhe shkathtesitë paraprake të nxënësve , teksti mesimor ,fletë A4 ,mjete shkrimi,ngjyra,veshje ilustruese për gjethen,erën,diellin.

Lidhja me fushat e tjera ose temat nderkurrikulare :Shkencat e natyrës ,shoqëria dhe mjedisi ,matematika, arte,të drejtat e njeriut ,mjedisi ,bashkejtesa paqësore.

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve : imagjinatë e drejtuar ,procedura pyetjesh, marrëdhënie pyetje –përgjigje ,rrjeti i diskutimit , punë individuale , punë në çift, punë në grup , punë me gjithë klasën ,diskutim ,lexo përmbledh në dyshe, lojë në role .

Zhvillimi i mesimit :

Ora e I (45 minuta)

Veprimtarite e nxenesve :

Imagjinatë e drejtuar Ftoj nxënësit/et të mbyllin sytë dhe të mendojnë:

Mendoni sikur jeni vetëm në një vend për shumë ditë, pa njerëz, shokë e shoqe përreth. Pranë teje ke gjithçka që të duhet për të jetuar: ushqime, veshje, lodra, libra etj. Si do të ndihesh? A do të mund të jetoje në këtë gjendje për shumë ditë? Nxiten nxënësit/et të shprehen lirshëm.

Procedura “pyet sërish”

Njoh nxënësit/et me titullin e tekstit dhe i fton të vërejnë ilustrimin. Nxënësit/et në dyshe e më pas me gjithë klasën diskutojnë rreth tij, duke treguar si i ndihmon për të kuptuar më mirë tekstin.

Lexim ne heshtje sipas paragrafeve.

Udhëzohen nxënësit/et të lexojnë tekstin në paragrafë. Nënvizojnë fjalët dhe shprehjet që nuk kuptojnë si dhe fjalitë që u duken më interesante e më të rëndësishme.

Diskutim në dyshe: njëri prej nxenesve ndërton dy pyetje rreth fjalive më interesante në paragrafin e parë dhe tjetri i përgjigjet pyetjeve.

Për çdo paragraf të ri nxënësit/et ndërrojnë rolet.

Lexim teksti + diskutim.

U lihet kohë nxënësve/eve ta lexojnë sërish për ta kuptuar më mirë tekstin. Nxënësit/et diskutojnë në dyshe dhe tregojnë llojin e tekstit, mbi bazën e karakteristikave të tij. (tregim).

Lexim zinxhir nga nxënësit/et.

Marrëdhënie pyetje-përgjigje

Në rubrikën: “Lexoj dhe kuptoj” nxënësit/et lexojnë pyetjet rreth tregimit. Diskutojnë në dyshe përgjigjet e pyetjeve dhe më pas me gjithë klasën. Nxënësit/et tregojnë përmbajtjen e përrallës sipas strukturës së saj.

Rrjeti i diskutim

A veproi mirë gjethja e pemës që i kërkoi erës t’ia këpuste të gjitha shoqet e saj ? Pse ?	Jo
--	----

Nxiten nxënësit/et të diskutojnë rreth pyetjes duke dhënë argumente pro dhe kundër dhe në fund të dalin në përfundimin:

Ta duam tjetrin me të gjitha cilësitë që ka.

Të vetëm nuk përballojmë dhe nuk shijojmë asgjë.

Ora e dyte (45minuta)

Diskutim

Zbuloni cilësitë e gjethes së pemës, duke ilustruar me pjesë nga teksti.

Nxënësit/et lexojnë fjalë të urta për miqësinë që janë porositur orene kaluar.

Lexo, përmblihd në dyshe;

Nxënësit/et lexojnë në dyshe çdo paragraf dhe e përmbledhin në 1-2 fjali. Behet aktivizimi i disa dysheve dhe vlerësimi i shokëve për to.

Permbledhje e tregimit të lexuar .

Tregohet përmbajtja e tregimit sipas rrjedhës së ngjarjes, nga disa nxënës/e, duke patur parasysh hyrjen, zhvillimin dhe mbylljen.

Ritregim i ngjarjes nepermjet teknikes **“Rrjeta e merimanges”**

Pune e pavarur: Lexo pjesen dhe dallo fjalet e personazheve duke ngjyrosur:

Fjalet e gjethes me të gjelber, diellit me të verdhe, dhe eres me gri. Në përfundim behet leximi kolektiv i fjaleve të personazheve si dhe diskutohet mbi saktësinë e gjetjes.

Punohet rubrika “Reflektoj”

Nxënësit/et shprehin ndjenjat dhe emocionet e tyre për gjethen e pemës dhe japin mendimet e tyre për mbylljen e kësaj historie.

Lojë me role

Organizoj klasën në grupe me nga kater veta në çdo grup. Ndahen rolet për çdo grup dhe kërkoj që nxënësit/et të lexojnë në heshtje fjalët e rolit përkatës (autori, gjethja, era, rrezja e diellit). Më pas nxënësit/et të ndarë në katërshë ushtrohen në lexim me zë sipas roleve.

Perzgjidhet grupi i cili ka paraqitur realizimin më të mirë në role nga 1 grup nxënësish bashkë me mesuesen që janë caktuar me pare.

Vlerësimi bëhet për:

leximin e tekstit, duke mbajtur shënime për fjalët e reja dhe fjalët e shprehjet që i pëlqejnë më shumë;

tregimin e llojit të tekstit mbi bazën e karakteristikave të tij;

pyetjet dhe përgjigjet e dhëna rreth përmbajtjes së tekstit;

tregimin e përmbajtjes së tekstit sipas strukturës së tij;

qëndrimin e mbajtur ndaj veprimeve të personazheve;

grykimin e dhënë në lidhje me temën që trajton tregimi;

paraqitjen dhe komunikimin lirshëm dhe saktë të mendimeve të tij/saj.

tregimin e interesit dhe dëshirës për të lexuar;

dallimin e cilësive të personazheve, duke u mbështetur tek veprimet e tyre;

interpretimin me role;

mendimin e tij/saj për mbylljen e kësaj historie;

vlerësimin për interpretimet e shokëve/shoqeve;

pranimin dhe tregimin e respektit ndaj ideve dhe mendimeve të të tjerëve;

respektimin e përpjekjeve individuale dhe atyre në grup.

Detyrë shtëpie:

a) Shkruaj një mbyllje tjetër për këtë histori.


b) Shkruaj cilësitë e gjethes së pemës dhe ngjyros në tekst fjalët ose fjalitë ku tregohen këto cilësi.

Hartoi dhe konceptoi

Mesuesja: Marie GJINI

Planifikim i orës mësimore

Fusha : Shkencat e natyrës	Lënda: Fizikë	Shkalla: 3	Klasa: VII
Tema Mësimore: Ora e parë: Energjia termike. Ora e dytë: Energjia e çliruar prej lëndëve djegëse.		Situata e të nxënit: 1. Në 100ml shtojmë 100ml uje të ftohet, matim temperaturën e përzierjes. A do jetë e njëjtë temperature e përzierjes, nëse në 50ml ujë të ngrohët shtojmë 50ml ujë të ftohet ? 2. Ngrohim 100ml ujë në një enë laboratorike . a). nën flakën e qiririt b). nën flakën e një llambe me alkol. A çlirojnë të njëjtë energji të dy ngrohësit.	
Rezultatet e te nxenit sipas kompetencave kyce <ul style="list-style-type: none"> • Kompetencat e komunikimit dhe te shprehurit • Kompetencat e te menduarit • Kompetencat e te nxenit • Kompetencat personale • Kompetencat qytetar Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi / ja : <ul style="list-style-type: none"> • Tregon se trupat e ngrohët zotrojnë energji termike. • Shpjegon se energjia është shpërhapur nga një trup i ngrohët i shkonë mjedis përreth. • Përdorë mjete për të treguar se trupat e ngrohët zotrojnë energji termike, si dhe shpërhapjen e energjisë së çliruar prej lëndëve djegëse. • Bën parashikime duke përdorur njohurit e të kuptuarit shkencor. • Përdor tabela dhe grafik për paraqitjen e rezultateve. • Analizon situatë të ngjashme dhe nxjerr përfundime. 		Fjalë kyçe: Energji termike, shpërhapje e energjisë	
Burimet: Teksti Fizika 7, material të përgatitura nga mësuesi, internet, Mjetet: Gotë kimike, ujë, termometër, kronometër, llampë alkoli,qiri.		Lidhja me fushat kurrikulare: Matematikë,TIK,Kimi.	
Metodologjia dhe veprimtarit e nxënësve Diskutim i lirë, demonstrim, punë në grup, punë me klasën.			



Nxënsi bazuar në përgjigjet e pyetjeve arrin në një përfundim të cilin e shkruan atë në fletore.
 Kërkoj nga nxënësit të shkruajnë në fletoren e klasës shëmbuj nga jeta reale për energjinë e shpërhapur nga një trup i ngrohtë përcuar në mjedisin përreth. **(10 min)**

Vlerësimi: (5 min) Për pjesëmarrjen në diskutim, saktësinë dhe shkathtësinë në përgjigje, për saktësinë e matjeve dhe arsyetimin gjatë hulumtimit rreth ndryshimit të temperaturës së ujit.

Detyrë shtëpie: Ushtrim nga fleta e punës

Punë e diferencuar: nxënësi të krijojë një esse e cila në përmbajtjen e sajë të shprehë kryerjen e veprimtarive të ndryshme që zotërojnë energji termike.

Punoi N/Dr

Majlinda PUPA

Shkolla 9-Vjecare MEZEZ-FUSHË

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematika 7	Shkalla: III	Klasa: VII
Tematika: Gjeometria		Situata e të nxënit: Mësuesi merr një trekëndësh barabrinjës dhe një trekëndësh dybrinjënjëshëm. Dhe kërkon nga nxënësit që të matin brinjët dhe këndet. Pastaj u drejton pyetjen: çfarë i dallon këta trekëndësha?	
Tema mësimore: 1. Vetitë e simetrisë së trekëndëshave, katërkëndëshave dhe shumëkëndëshave Tema mësimore 2. Përsëritje			
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/-ja: <ul style="list-style-type: none"> • përshkruan trekëndëshat, katërkëndëshat dhe shumëkëndëshat duke përdorur brinjët, këndet dhe drejtëzën e simetrisë. • Përdor matjet në figurat 2D • Përshkruan trekëndëshat, katërkëndëshat dhe shumëkëndëshat duke përdorur brinjët, këndet dhe drejtëzën e simetrisë. 		Fjalë kyç: trekëndësha çfarëdo trekëndësha barabrinjës trekëndësha dybrinjënjëshëm trekëndësha kënddrejtë shumëkëndësha çfarëdo simetri drejtëz e simetrisë	
Burimet: libri i nxënësit, fletorja e punës, figura të ndryshme.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Artet Shkencat e natyrës Shoqëri dhe mjedis	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Organizimi i orës së mësimimit			
<u>Ora e parë</u> Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme (diskutim) Pas kontrollit të detyrave të shtëpisë, diskutohet për zgjidhjen e tyre. Ndërtimi i njohurive të reja (punë e drejtuar, diskutim) Parashtrohet për nxënësit situata e parashikuar Theksohen vetitë e simetrisë së figurave, trekëndësh, katërkëndësh dhe shumëkëndësh Nxënësit punojnë ushtrimin 4 dhe 6 në faqen 92, 93 dhe ushtrimin 5 në faqen 93 nga libri i nxënësit. Diskutojnë edhe për zgjidhjen e ushtrimit 6 po në këtë faqe. Zgjidhjet shoqërohen edhe me figurën e vizatuar në dërrasë.			

Ora e dytë

- Kërkohet nga nxënësit që të vizatojnë në fletore figurat e studiuara në këtë kapitull (trekëndësh, drejtkëndësh, paralelogram, katror, romb, trapez, balona
- Disa nxënës vizatojnë këto figura edhe në dërrasë
- Kërkohet nga nxënësit të përshkruajnë secilën prej këtyre figurave duke përdorur fjalët: brinjë, kënde, paralele, të barabarta, kulme, diagonal etj.
- Nxënësit punojnë në dyshe ushtrimet nr. 2 dhe 3 në faqen 49 të fletores së punës.
- Dy nxënës prezantojnë zgjidhjet në dërrasë.
- Diskutohen me të gjithë nxënësit përgjigjet e dhëna.



Vlerësimi:

Vlerësohen nxënësit për formulim të saktë të figurave gjeometrike të njohura.
Për saktësi të zgjidhjes së ushtrimeve.
Për argumentimin e zgjidhjeve të paraqitura.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Ushtrimet nr.6 faqe 94 Libri I nxënësit, nr. 1, 4 faqe 49 fletorja e punës.

Punoi:Qazim BRAHO

Fusha: Matematikë	Lënda: Matematikë	Shkalla: 4	Klasa: IX
Tema mësimore 1. Harku dhe gjatësia e tij 2. Zbatime të formulës për gjatësinë e harkut.			
<p style="text-align: center;">Situata e të nxënët:</p> <p>Një litar me gjatësi 16 m, nën veprimin e peshës së vet formon një hark rrethi me masë 156°. Sa është rrezja e këtij harku?</p>			
<p>Rezultatet e të nxënët të kompetencave të fushës sipas temës mësimore</p> <p>Nxënësi aftësohet të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përdor matjet në figurat 2D për zgjidhjen problemore. • Zhvillon dhe zbaton shprehi të arsytimit. • Gjen gjatësinë e një harku rrethi duke përdorur formulën $l = \frac{\pi R n}{180}$. • Zbaton formulën në situata problemore nga jeta e përditëshme. 			
Fjalët kyçe: Rreth Hark rrethi Perimetër Gjatësi e harkut Formulë	Burimet: Teksti i nxënësit. Mjete: Vizore, kompas	Lidhja me fushat kurrikulare dhe temat ndërkurrikulare: Gjuhë dhe komunikim Shkencat e natyrës Shoqëri dhe mjedis.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
<p>Ora e parë</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kontrollohet dhe diskutohet zgjidhja e ushtrimeve të detyrës • Përsëritet kuptimi I sipërfaqes (përsëriten dhe shënohen në dërrasë formulat për sipërfaqen e paralelogramit, trekëndëshit, drejtkëndëshit, katrorit, rombit, trapezit) • Shtrohet për diskutim situata e parashikuar dhe lejohen nxënësit të diskutojnë me njëri – tjetrin. • Udhëzohen dhe lejohen të lexojnë informacionin në tekst faqe 142 – 143. • Jepet kuptimi I këndit qëndror dhe këndit rrethor. (vizatohet figura edhe në dërrasë). <div style="display: flex; justify-content: space-around; align-items: center;"> <div style="text-align: center;">  </div> <div style="text-align: center;">  </div> <div style="text-align: center;"> $P = \pi R^2$ $l = \frac{\pi R n}{180^\circ}$ </div> </div> <ul style="list-style-type: none"> • Diskutohet me nxënësit dhe argumentohet nxjerja e formulës $l = \frac{\pi R n}{180^\circ}$ për llogaritjen e gjatësisë së harkut të rrethit. • Kërkohet të veçojnë sipas rastit “R” ose “n” nga formula e zbuluar. 			

Ora e dytë (zbatime të formulës në situatë problemore)

- Diskutohet shembulli 1 faqe 143 dhe 2 faqe 144. (nxënësve ju kërkohet të argumentojnë zgjidhjet e ofruara).
- Jepet nga nxënësit përgjigje për situatën e parashtruar.

Veprimtari individuale

- Zgjidhen nga nxënësit, në fletore (individualisht), ushtrimet 1, 2, 3,4 faqe 144.
- Katër nxënës prezantojnë zgjidhjet në dërrasë.

Diskutohen me të gjithë nxënësit.

Vlerësimi:

Vlerësimi i arritjeve bazuar në përgjigjet me gojë të nxënësve dhe punët e pavarura.

Vlerësohen nxënësit për saktësi të zgjidhjes dhe për argumentim.

Detyra dhe puna e pavarur:

Jepet ushtrimi nr. 5 dhe nr. 6 faqe 144

Punoi:Qazim BRAHO


LESSON PLAN

Grade: XI	Field: Language and communication	Subject: English	Stage: V
Topic 1: The camera never lies; Reading Topic 2: Vocabulary: Crime and Punishment		Learning situation: The students read and discuss about a forensic photographer's job. They use words related to crime and punishment in different situations.	
Learning outcomes: <ul style="list-style-type: none"> - identify the author's purpose in writing the text - explain the highlighted words in the text - interpret the information in the text by answering questions it - list 10-12 words for crime and criminals - choose the correct word to complete the sentences - fill in the gaps in the text using the appropriate words 			
Key words: forensic photographer, brief, evidence, investigation, crime punishment, precautions		Sources: Textbook On Screen B1.2, Internet	
Methodology and activities: Discussion, Guided reading, Venn Diagram, Group work		Cross-curricular links: Society and citizenship	
<p>1st class - 45 minutes</p> <p>Step 1: Warm up discussion (10 minutes)</p> <p>Do you watch crime drama series on TV? If yes, what's your favourite? Why? What's it like to work in Forensics? Which are the challenges?</p> <p>Step 2: Guided reading (15 minutes)</p> <p>The students check the words in the word list. Then they listen to the text. After that the students read the text themselves. They read the first sentence of each paragraph and then elicit what each paragraph is about.</p> <p>Step 3: Individual work (20 minutes)</p> <p>The students work in pairs. The students choose the best answer A, B, C or D for each of the questions 1-6. They have to justify their answers. Then the students answer questions in their own words, based on the text. After that they explain the highlighted words in the text.</p>			

2nd class - 45 minutes

Step 1: Venn Diagram (10 minutes)

How many words for crime and criminals can you mention?



Step 2: Group work (25 minutes)

I divide the class into three groups and I give each group 2-3 exercises.

Group 1 - Exercises 1, 2, 3

Group 2 - Exercises 4, 6

Group 3 - Exercises 7, 8, 9

I monitor the students as they work. Then they read the exercises and I check their answers.

Step 3: Summarising the lesson (10 minutes)

How many words related to crime and punishment can you mention?

What is Robert Mars' attitude towards his job?

What are some of the things we can do to prevent crime?

Assessment: Individual evaluation

Assignment: Exercises 1-5 page 46 (Workbook)

KLASA E DYTE

Fusha:Gjuha dhe komunikimi

LENDA:Gjuhe shqipe

Tema mesimore. Nje dhurate e vecante.

Nje dhurate e vecante .

Situata e te nxenit: Nje feste ditelindje. Foto nga ditelindjet.

Rezultatet e te nxenit te kompetencave te fushes sipas temes mesimore.

*Lexon rrjedhshem dhe me kuptim pjesen.

*Shpjegon kuptimin e fjaleve te reja.

*Pershkruan festen e ditelindjes se tij/saj.

*Ritregon permbajtjen me fjalet e tij duke u ndihmuar nga harta e ngjarjes.

*Ndan emocionet e ditelindjes se tij me te tjeret.

Fjalet kyc:ditelindje,kenga e ditelindjes,kompozoj,dhurata,ritregim,emocion.

Burimet:Teksti i nxenesit,cd me kenget e ditelindjes,foto ditelindjesh,videoprojetor.

Lidhja me fushat e tjera:Arte.

Metodologjia: Degjim i drejtuar,lexim i drejtuar,pershkrim i lire,lexim -ritregim,harta e ngjarjes,rrjet diskutimi.

Veprimtarite e nxenesve.

Hapi i pare. Shikim I organizuar.

Nxenesesve u paraqitet ne videoprojektor nje feste ditelindje,ku shikojne me vemendje duke iu tehequr vemendjen ne detajet e festes.

***Cilat jane aspektet me te rendesishme te ditelindjes?**

-Nxenesit japin idete e tyre ,te cilat shkruhen ne tabele:Urimet,dhuratat,zbukurimet,torta,qirijte,kenga.

Ndertimi i njohurive.

Hapi i dyte. : Lexim i drejtuar

Shkruaj ne tabele temen e re “Nje dhurate e vecante” e autores **Shpresa Vreto.**

***Ndahet pjesa ne paragrafe,dhe per cdo paragraf u drejtohen disa pyetje.**

Paragrafi.I. Fillon .Te dielen deri te shoke dhe shoqe.

*Kush e ka ditelindjen? *Cilet erdhen per ta uruar? *Cfare ndodh me pas?

Paragrafi.II. Me zemer.....puthje te embel.

*Cfare merr ajo nga njerezit me te dashur?

*Trego disa nga dhuratat e saj?

*Si reagon ajo?

Paragrafi.III. Ne fund e mrekullueshme.

*Cfare i tha daje Petriti? *Si ishte dhurata e tij? *Si u ndje Genta? *Ju pelqeu surpriza e dajes se saj? *Si do te veproje ti po te ishe ne vend te Gentes? *Cila ka qene surpriza e ditelindjes sate? * Te pelqen mbyllja? Pse?

Shpjegojme fjalet e reja te dhene ne tekst. Surprize- dicka qe ndodh kur nuk e presim.

Kompozoj muziken,kengen-e krijoj,e shkruaj ne nota muzikore,qe te luhet me pas si muzike.

Hapi i trete. Pershkrim i lire.

Nxenesit do te pershkruajne mbresa nga ditelindjet e tyre,vizatojne dhuratat te cilat ka qene surprize per to.

*Gjate punes nxenesit degjojne kenge te festes.

ORA E DYTE.

Hapi i pare. Shikim i organizuar.

*Nxenesit ftohen te shohin me njeri-tjetrin foto te ditelindjeve te tyre.Nxiten te diskutojne se si jane ndjere ate dite.

Hapi i dyte. Lexim-ritregim.

*Ftoj nxenesit te lexojne tregimin ne paragrafe.Me pas nxenesit plotesojne harten e ngjarjes.

HARTA E NGJARJES: Nje ditelindje e vecante.

1.Kur e kishte ditelindjen Genta?

2.Kush erdhi per ta uruar?

3.Cfare dhuratash mori ajo?

*Ftoj nxenesit ta ritregojne ngjarjen me fjalet e tyre ose duke lexuar harten e ngjarjes.

Hapi i trete. Punohet rubrika PLOTESO DHE SHKRUAJ.

Plotesohet rubrika . Po ti?

Perforcimi: Rrjet diskutimi.

PO

JO

A duhet te merzitemi kur nuk marrim

dhuraten qe kemi menduar?

Perfundimi:Jo. E rendesishme eshte qe miqte tane jane me ne.Sido qe te jete dhurata,ajo eshte gjithmone e bukur.

VLERESIMI:Nxenesit vleresohen ne menyre individuale per mendimet e shprehura,pershkrimet,detajet e perdorura gjate pershkrimit,argumentat e dhena.

DETYRE SHTEPIE. Pershkruaj shkurt disa nga dhuratat qe te kane pelqyer me shume.

Punoi: VEBI DOKA
Shkolla :17 Shkurti Qesarake

PLANIFIKIMI ORËS MËSIMORE 90 MINUTA

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Letërsi	Shkalla: V	Klasa: XI
Tema mësimore nr. 1 Analizë “Lulet e verës” Naim Frashëri Tema mësimore nr. 2 Koment “Fyelli” Naim Frashëri			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës së mësimit nr. 1 Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> Dallon gjerësinë e tematikës, thellësinë e ndjenjës, bukurinë e vargut në vëllimin <i>Lulet e verës</i>. Dallon lirizmin, si prirja më e natyrshme e talentit të Naimit Dallon temën dhe motivet në vepër; Analizon gjendjen emocionale që krijohet nga mjedisi,(koha, vendi, detajet fizike, situatat) apo rrethanat e një teksti. 			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore sipas temës së mësimit nr. 2 Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> Dallon tematikën dhe motivet në poezi si dhe shpjegon rëndësinë e tyre në fragmentin “Fyelli”; Dallon simbolikën si element i poezisë meditative -filozofike; Veçon tiparet e stilit dhe analizon e shpjegon se si ndikojnë ato te lexuesi dhe në tekst si p.sh.: gjuha (p.sh., zgjedhja e fjalëve); përdorimi i gjuhës së figurshme (krahasimi, metafora, personifikimi, simboli, epanastrofeja, hiperbola, ironia etj.); Muzikaliteti (ritmi, rima, strofa, aliteracioni, onomatopeja, asonanca etj.); Analizon ndjenjat që e karakterizojnë heroin lirik. 			
Fjalë kyçe: <ul style="list-style-type: none"> motiv erotik patriotik filozofik panteizmi 	Burimet dhe mjetet mësimore: <ul style="list-style-type: none"> Teksti shkollor Vepra “Lulet e verës” Flipchart Tabela e zezë 		
Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuhë shqipe	Situata e të nxënit: Interpretimi i vargjeve nga vëllimi “Lulet e verës” Koment “Fyelli”		
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: <i>Diskutim mbi njohuritë paraprake, Pema e mendjes, Diskutim, Praktikë e udhëhequr. Lexim shprehës, Koment letrar.</i>			

Organizimi i orës mësimore:

Pjesa e parë e orës (45 minuta)


A. Lidhja me njohuritë e mëparshme

Diskutim mbi njohuritë paraprahe :

Mësimi fillon me kontrollin dhe diskutim i detyrave të shtëpisë. Komentohen *Bagëti e bujqësia* dhe *Histori e Skënderbeut*. Ku qëndron e veçanta e romantizmit të Naimit në secilën prej këtyre dy veprave?

B. Ndërtimi i njohurive të reja

Pema e mendjes: Rreth vëllimit "Lulet e verës" Informacionet dhe diskutimet e nxënësve grupohen në një pemë mendjeje.



C. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Diskutim:

1. Cilat janë tri çështjet themelore të krijimtarisë meditative-filozofike të Naimit në vëllimin *Lulet e verës*?

2.

- a. Ç'është Zoti për Naimin?
- b. Ç'atribute i njeh poeti atij?

c. Shpjegoni kuptimin e panteizmit si thelb i filozofisë së Naim Frashërit.

3. Në ç'raporte vendosen jeta, vdekja dhe koha e shkuar në poezinë meditative-filozofike të Naimit?

4. Diskutoni për Naimin si poet i dashurisë, duke u ndalur në të veçantën e tij.

Nxënësi analizon gjendjen emocionale që krijohet nga mjedisi, (koha, vendi, detajet fizike, situatat) apo rrethanat.

Motivohen nxënësit që u aktivizuan më shumë dhe që dhanë përgjigje të qarta e të sakta.

Pjesa e dytë e orës (45 minuta)

Lexim shprehës: Lexohet bukur fragmenti duke krijuar atmosferë në klasë.

B. Ndërtimi i njohurive të reja

Veprimtari e leximit të drejtuar.

*Në këtë fazë të orës së mësimit nxënësit do të punojnë me tekstin poetik, poezinë *Fyelli* duke e interpretuar dhe komentuar atë.*

1. Poezia *Fyelli* është lirikë që filozofon: për dhimbjen dhe shpirtin njerëzor

2. Mesazhi i poezisë *Fyelli* është: poezia është arti i dashurisë, i dhimbjes, i humbjes dhe i fitores së njeriut.

3. Në poezinë *Fyelli* gjenden të gërshetuara disa motive. Cilat janë ato?

Në poezi gjenden të gërshetuara motivi meditative-filozofik, motivi atdhetar, i vetmisë.

4. Ç'është fyelli në poezi? Kush fshihet pas tij?

Fyelli simbolizon njeriun. Shfaqet kulti i shpirtit njerëzor. Vetë fyelli simbolizon poetin, vetë melodia e tij prek telat e shpirtit njerëzor.

5. Fyelli ankohet e vuan pse s'e dëgjojnë apo pse s'e kuptojnë? Arsyetoni përgjigjen.

Model përgjigjeje.

Poetit vuan sepse nuk e kuptojnë atë, nuk e njohin zjarrin brendshëm të tij. Poeti materien, zjarrin e ka vënë në themel të krijimit të gjithësisë, po ai zjarr i ka dhënë trajtë.

6. Ku e gjeni të shprehur në poezi panteizmin e Naimit? Ilustroni me vargje.

a. Ndajeni poezinë në pjesë dhe thoni për çfarë këndon poeti në secilën prej tyre.

- Zëri i fyellit, dhimbja e poetit (7 strofat e para).

-Zëri i fyellit, zjarri brendshëm (8 deri në fund).

b. A është procesi i krijimit shkaku i vuajtjes së Naimit artist? A ka shkaqe të tjera që përcaktojnë dhimbjet, vuajtjet e poetit? Nëse po, të ç'natyre janë këto shkaqe?

Atë e shqetëson ndarja nga njerëzit, mërgimi, jo vetëm ai fizik, po sidomos, ai shpirtëror. Ata sikur nuk e kuptojnë vuajtjen e tij.

8. Fyelli është i vetmuar që është i vetëm në jetë apo është i vetmuari midis njerëzve? A ka të bëjë vetmia e Fyellit me vetminë e romantikëve? Arsyetoni përgjigjen, duke u mbështetur në ilustrime.

1. Qëkurse më kanë ndarë
Nga shok' e nga miqësija,
Gra e burra kanë qarë
Nga ngashërimat' e mija.

2. Dhe me botën e gëzuar
Bënem shok edhe marr pjesë
Dhe me njerës të helmuar
Bënem mik me besa-besë.

9. Cili është kuptimi i vargut "bëri soje njerinë"? Me ç'pikëpamje të Naimit kemi të bëjmë? *Procesi i krijimit, panteizmi.*

10. Zjarri në poezi është një nga katër elementet e krijimit të universit apo simbol me kuptim disaplanësh? Argumentoni përgjigjen.

Me atë zjarr është rishkrirë edhe shpirti i poetit, i cili do të vazhdojë të jetojë përjetësisht.

11. Si e ndërton poeti ligjeratën e tij poetike? Ç'i sjell kjo mënyrë ndërtimi poezisë?

Ligjërata poetike ndërrohet në vetën e parë. Kjo e bën poezinë më subjektive, një shprehje të drejtpërdretë të unit poetik, e bën më emocionale duke i dhënë trajtën e një monologu lirik intim.

12. Gjeni vargjet ku poeti jep një përfytyrim konkret të sakrificës që bën poeti. Si janë shprehur artistikisht ato?

1. *I ra qiellit, e ndriti,
I ra zëmërsë, e nxehu.
I ra verës, e buçiti,
I ra shpirtit dhe e dehu.*
2. *I dha erë trëndafilin,
I dha dritë bukurisë,
I dha këngëtë bilbilit,
I dha shije gjithësisë.*

13. Kujt u drejtohet poeti me apostrofën e papritur *O rrëmet i njerëzisë*? A e vëmë re ballafaqimin e pashprehur mes fyellit dhe poetit?

Njerëzve, vëmë re ballafaqimin e pashprehur mes fyellit dhe poetit

C. Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura

Praktikë e udhëhequr:

Nxënësve pasi kanë komentuar poezinë, u jepet detyrë të gjejnë mjetet stilistike. Nxënësi veçon tiparet e stilit dhe analizon e shpjegon se si ndikojnë ato te lexuesi dhe në tekst si p.sh.: gjuha (p.sh., zgjedhja e fjalëve); përdorimi i gjuhës së figurshme: *Mërgimet e shkreta, zjarr i bekuar-epitete metaforike*

Psherëtin zemra ime-personifikim

Bëri soje njerinë, të kam shpirt- metonimi

I dha , i ra -përsëritja etj.

Vlerësimi:

Nxënësi vlerësohet për përdorimin e strategjive të ndryshme për të kuptuar tekstin, për gjetjen e figurave, për evidentimin e veçorive të tekstit romantic, për komentet dhe interpretimet e tekstit poetik.

Detyrë shtëpie:

Grupi .A Analizoni poezinë “Bilbili”

Grupi. B Analizoni poezinë “Fjalët e qiririt”

Nxënësit me vështirësi në të nxënë: Mësoni përmendësh 7 strofat e para të poezisë “Fyelli”